



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1079_12_13**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 05.02.2014.

në seancën e mbajtur më datë 12 mars 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHE** ankesa e konsumatorit A.M. (me shifër DPR – 2001105) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1079_12_13 i datës 26.12.2013.

Arsyetim

Me datë 19.11.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 2001105, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 8190527 me gjendje TL=54156 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=51174 kWh (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 62276045 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Departamenti i faturimit në KEK me datë 05.03.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin shkurt 2013 në vlerë financiare **316.52€**.

Me datë 08.03.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e energjisë elektrike të muajit shkurt 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë për periudhat dhjetor 2012, janar dhe shkurt 2013.

Me datë 12.03.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 62276045: TL=002799 kWh dhe TU= 000515 kWh.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 07.06.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 26.12.2013 ka nxjerr vendim duke e **refuzuar** ankesën e konsumatorit me arsyetimin se korrigjimi i bërë nga ana e KEDS është i saktë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore.



Baza e kundërshtimit të konsumatorit në ankesë është se DMK e ZRRE-së, gjatë shqyrtimit të kësaj lënde nuk ka marr për bazë pretendimet e mia në ankesë për shkak se më është bërë një mbingarkesë sa i përket faturimit të muajit 02/2013 krahasuar me periudhat e mëhershme pasi që mesatarja e shpenzimit mujor ka qenë rreth 50€, ndërsa për muajin 02/2013 jam faturuar në vlerë prej 316€, ku me këtë rast jam dëmtuar si konsumator.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se Departamenti i faturimit në KEK me datë 07.12.2012 ka faturuar konsumatorin për periudhën 11/2012 vetëm me taksa në vlerë 2.36 € duke mos faturuar konsumatorin për shpenzimet e krijuara në muajin nëntor 2012, me datë 04.01.2013 Departamenti i faturimit në KEK ka faturuar konsumatorin për periudhën 12/2012 vetëm me taksa në vlerë 2.36 € duke mos faturuar konsumatorin për shpenzimet e krijuara në muajin dhjetor 2012. Ndërsa me datë 03.02.2013 Departamenti i faturimit në KEK ka dërguar tek konsumatori faturën mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 302 kWh apo shprehur në vlerë financiare 11.48 €, e që paraqet diferencën e leximit për periudhën tetor 2012 dhe shpenzimeve të regjistruara në vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0099710 të datës 19.11.2012 për njehsorin elektrik nr. 8190527, ndërsa me datë 05.03.2013 Departamenti i faturimit në KEK e ka ngarkuar konsumatorin për muajin 02/2013 me shpenzim mujor prej 3,108 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 316.52 €. Po ashtu gjatë analizave të shkresave të lëndës vërehet se punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 19.11.2012 kanë dalur te konsumatori për të bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 8190527 me gjendje TL=54156 kWh dhe TU=51174 kWh, dhe kanë vendosur për matje njehsorin e ri nr. 62276045 me gjendje TL=0 kWh dhe TU=0kWh.

Nga shkresat e lëndës shihet se punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 62276045, e cila ka qenë: TL=002799 kWh dhe TU=000515 kWh. Gjendja e shpenzimeve të regjistruara në procesverbal përputhet me gjendjen e shpenzimeve të evidentuara nga lexuesi i KEK-ut në listën e leximit për periudhën shkurt 2013, si dhe me gjendjen e regjistruar në programin e faturimit (*ang. Customer Care Package "CCP"*) për periudhën shkurt 2013.

Sipas analizave të bëra nga rrjedha e energjisë elektrike si dhe listave të leximit për periudhën 01/2013 dhe 02/2013 konstatohet se konsumatori ka lexim të rregullt mujor të shpenzimit të energjisë elektrike, por që shpenzimet e konsumatorit të regjistruara në njehsorin e ri elektrik nr. 62276045 nuk janë regjistruar në CCP deri në periudhën shkurt 2013. Sipas listës së leximit për periudhën janar dhe shkurt 2013 konstatohet se lexuesi i KEK-ut ka evidentuar që kemi ndërrim njehsori (periudha janar 2013), si dhe kilovatët e regjistruar kilovatët në njehsorin elektrik nr. 62276045. Sipas listave të leximit shpenzimet e evidentuara nga lexuesi i KEK-ut janë: në periudhën janar 2013 gjendja ka qenë TL=002074 kWh dhe TU=000348 kWh, dhe në periudhën shkurt 2013 gjendja ka qenë TL=002642 kWh dhe TU=000476 kWh.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar edhe korigjimin e bërë nga ana e Departamentit të faturimit të KEK korigjimi me numër 48911DPR-2001105 të datës 26.03.2013 në vlerë prej (-58.57€) dhe ka vërejtur se KEK-u ka bërë grumbullimin e shpenzimit të energjisë elektrike të regjistruar në dy njehsorët elektrik: nr. 8190527 (kilovatët e regjistruar nga leximi i fundit i muajit 10/2012 e deri më 19.11.2012: TL=44 kWh dhe TU=258 kWh) dhe nr. 62276045 (kilovatët e regjistruar nga periudha 19.11.2012 e deri në leximin e bërë të muajit 02/2013: TL=2642 kWh dhe TU=476 kWh), dhe se këtë grumbullim të kilovatëve e ka shpërndarë proporcionalisht për 4 muaj, natyrisht duke e zbritur edhe faturat gjatë kësaj periudhe. Pas llogaritjeve të bëra vërehet se korigjimi i bërë nga KEK-u (tani KEDS) është i saktë dhe se edhe përkundër gabimeve të bëra nga KEK-u ndaj konsumatorit për mos faturim të saktë dhe të rregullt të energjisë elektrike gjatë periudhës 11/2012 e deri më 02/2013, nuk ka elemente të tjera të korigjimit.



Bordi i ZRRE, pas analizimit të gjithë rrjedhës së kësaj lënde ka konstatuar se konsumatori edhe përkundër faktit se dyshon në korgjimin e bërë nga ana e KEK, i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi shtesë me të cilën do të vërtetonte faktin se korrigjimi i KEK dhe vendimi i DMK-së, nuk është i drejt dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1079_12_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar